

VENDIM
Nr. 146, datë 22.2.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.575, DATË 10.7.2013, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR VLERËSIMIN DHE
DHËNIEN ME KONCESION/ PARTNERITET PUBLIK PRIVAT”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 5, 21, pika 2, 24, pika 5, 25, pika 7, 42, pika 3, e 49, të ligjit nr.125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin “Rregullat për vlerësimin dhe dhënie me koncesion/partneritet publik privat”, miratuar me vendimin nr.575, datë 10.7.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3, e nenit 9, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Projekti, që përmbush të gjitha kushtet e pikës 1, të këtij neni, më tej paraqitet për miratim në Ministrinë e Financave, e cila e shqyrton atë dhe vlerëson nëse është i nevojshëm edhe miratimi i saj në përputhje me nenin 42, të ligjit për koncesionet dhe PPP-të. Në rast se projekti nuk ka nevojë për mbështetje financiare, Ministria e Financave konfirmon vazhdimin e procedurave, brenda 10 ditëve pune nga paraqitja e projektit. Në rast se konfirmimi nuk paraqitet brenda 10 ditëve pune, atëherë, ai quhet i dhënë.”.

2. Në nenin 17 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Ministria e Financave vlerëson dhe miraton paraprakisht të gjitha projektet koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP), nga pikëpamja e implikimeve fiskale, individuale apo në grup për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale, pavarësisht nga modeli i parashikuar i koncesionit/PPP dhe mënyra në të cilën ato janë nisur, d.m.th., propozim i kërkuar apo i pakërkuar. Nëse do të ketë ndryshime të mëtejshme në studimin e fizibilitetit pasi është paraqitur fillimisht për miratim në Ministrinë e Financave, autoritetet kontraktore duhet ta paraqesin sërish për miratim në Ministrinë e Financave për të verifikuar implikimet e mundshme fiskale.

Në rast se projekti koncesion/PPP nuk ka nevojë për mbështetje financiare, Ministria e Financave konfirmon vazhdimin e procedurave, në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 9.”.

b) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Edhe projektet e koncesioneve/PPP, që pësojnë ndryshime të kontratës apo transferim të saj në përputhje me ligjin për koncesionet dhe partneritetin publik privat, duhet të dorëzohen pranë Ministrisë së Financave e cila i vlerëson dhe miraton paraprakisht nga pikëpamja e implikimeve fiskale, individuale apo në grup për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale. Në rast se këto projekte nuk kanë nevojë për mbështetje financiare, Ministria e Financave konfirmon vazhdimin e procedurave, brenda 10 ditëve pune nga paraqitja e projektit. Në rast se konfirmimi nuk paraqitet brenda 10 ditëve pune, atëherë, ai quhet i dhënë.”.

3. Pika 2, e nenit 22, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Autoriteti kontraktues, përpara dërgimit për miratim në Ministrinë e Financave të një projekti koncesioni/PPP, duhet të garantojë që kostot përkatëse të projektit janë të planifikuara të përballohen brenda buxhetit vjetor të miratuara nga Kuvendi, si dhe brenda tavaneve të shpenzimeve për periudhën afatmesme, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

4. Pika 1, e nenit 23, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Çdo ndryshim ose transferim i kontratës së koncesionit/PPP, i ndërmarrë në përputhje me ligjin për koncesionet dhe partneritetin publik privat, duhet të dorëzohet në Ministrinë e Financave për miratim paraprak, e cila vlerëson dhe verifikon implikimet e mundshme fiskale të drejtpërdrejta ose jo të drejtpërdrejta mbi buxhetin e autoritetit kontraktues, buxhetin e shtetit ose që ndryshon në çfarëdolloj mënyre mbështetjen financiare.

Në rast se çdo ndryshim apo transferim i kontratës, i hartuar nga autoriteti kontraktues, nuk ka nevojë për mbështetje financiare, Ministria e Financave konfirmon vazhdimin e procedurave, në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 9.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama